



RAPORT MONITORIMI
FINANCAT & EKONOMIA
Gusht - Tetor 2020



REPUBLIKË SHQIPËRISË
**MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

AUTOR
ANILA SALIANJI

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom around the World

www.qeverisja.qq.com.al

Buxheti 2021.
buxheti i rimëkëmbjes ekonomike
apo një buxhet elektorale?

1. PASOJAT EKONOMIKE AFATGJATA TË KRIZËS

Efekti i krizës së COVID-19 për vitin 2020 ka qënë më i madh se parashikimet fillestare dhe kjo ka nxitur FMN që më datë 28 shtator 2020, të rishikojë ecurinë ekonomike për vitin 2020 në ulje nga - 5% në -7.5%, në krahasim me një vit më parë. Gjithashtu rimëkëmbja ekonomike për vitin 2021 është riparë në ulje, ndikuar nga efektet dhe kohëzgjatja e deritanishme e krizës, pasiguritë ende të pranishme dhe ndikimi në sjelljen e operatorëve ekonomikë. Borxhi publik në fund të vitit 2020, sipas FMN, pritet të kapë një nivel pak mbi 80% të PBB-së ¹.

Në një linjë më FMN, Banka Botërore në publikimin e datës 7 tetor 2020, parashikon që ulja ekonomike për vitin 2020 do të jetë -8.4%. Për vitin 2020 dhe 2021, rritja ekonomike në skenarin bazë parashikohet në 5% dhe 3.5%. Pasiguritë ende të larta mund të ndikojnë në këta tregues. Sipas Bankës Botërore, borxhi publik i Shqipërisë do të kapë një nivel prej 81.3% të PBB-së për vitin 2020. Ky borxh për vitet 2021 dhe 2022 pritet të jetë 81% dhe 79.3% e PBB-së. Parashikimet tregojnë se me këto ritme, vetëm në fund të vitit 2022 ekonomia shqiptare do të arrijë nivelin e fundit të vitit 2019.

¹ <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/34518/9781464816437.pdf>

Bazuar edhe në këto parashikime, Qeveria ka rishikuar edhe Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2021 – 2022² dhe në versionin përfundimtar të buxhetit pritet një ritje ekonomike pozitive prej 5.5% përgjatë vitit 2021.




Fig.1. Parashikimet për Rritjen Ekonomike

Ligji aktual për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH përcaktohen që “vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.”³ Ky ndryshim ligjor u bë pas vitit 2013 si masë për të mos lejuar hartimin e buxheteve optimiste në të ardhura dhe rritje ekonomike, që për shkak të mos-realizimit sillnin probleme me detyrime të prapambetura dhe borxhin publik. Pra vlera për PBB nominale në lekë që do të përdoret në hartimin e buxhetit 2021 nuk duhet të kalojë vlerën e parashikuar së fundmi në World Economic Outlook. Por mesa duket, përtej këtij detyrimi ligjor, që projektbuxheti të hartohet në mënyrë realiste, **buxheti i vitit 2021 ka tone të mëdha optimizmi, sic shihet edhe në grafikët e mëposhtëm.**

² <http://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/Kuadri-Makroekonomik-e-Fiskal-i-Rishikuar-p%C3%ABr-Periudh%C3%ABn-2021-2023-VKM-Nr.-574-dat%C3%AB-22.7.2020.pdf>

³ <http://www.financa.gov.al/ligjet/>

Nga sa shihet më poshtë, konstatohen lehtësisht dy elemente. Së pari, *ritja ekonomike e parashikuar nga MFE për vitet 2020 dhe 2021 është optimiste* edhe kundrejt parashikimit të bërë nga FMN dhe BB . Së dyti, *të ardhurat si përqindje e PBB-së në 2021 janë shumë ambicioze*, duke qenë se Shqipëria nuk ka arritur këtë nivel të ardhurash ndaj PBB-së as në vite të qeta.




Fig.2. Ecuria e të Ardhurave Buxhetore




Fig.1.3 Ecuria e Borxhit Publik

2.TË ARDHURAT

Sipas projektbuxhetit fillestar të prezantuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të miratuar në parim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, të ardhurat e pritshme në buxhetin e shtetit gjatë vitit 2021 do të jenë 478.9 miliardë lekë. Por gjatë shqyrtimit të këtij buxheti në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë, dhe sugjerimeve perkatëse për rritje të shpenzimeve buxhetore me rreth 5.3 miliardë lekë, komisioni propozoi rritjen e të ardhurave buxhetore me mbi 4.6 miliardë leke por pa dhënë asnjë koment më tepër se si do të mundësohet kjo rritje të ardhurash dhe pa analizuar mundësitë reale të kësaj rritje.

Vlen të theksohet se të ardhurat buxhetore që qeveria pritet të mbledhë gjatë vitit 2021 janë 10.6% më të ardhurat e parashikuara të vitit 2020. Kontributin më të madhe në këtë rritje të ardhurash sipas Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave pritet ta sjellin tatimet dhe doganat me një rritje prej 12.2% në krahasim me vitin e kaluar.



Këto parashikime tejet optimiste të qeverisë, janë padyshim të vështira për t'u realizuar duke marrë parasysh faktin që në 9 mujin e parë të këtij viti qeveria arriti të mbledhte 290 milionë Euro ose 10% më pak nga parashikimi. Vështirë i realizueshëm duket palni të ardhurave për vitin 2021 edhe për shkak të ndryshimit të politikës fiskale që pritet të kenë ndikim të drejtpërdrejtë negativ në nivelin e të ardhurave. Këto ndryshime fiskale përfshijnë:

- Rritja e pragut të TVSH-së nga 2 milionë në 10 milionë lekë. Pra bizneset me të ardhura deri në 10 milionë lekë, nuk do të paguajnë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Ky ndryshim parashikohet të sjellë një efekt negativ në të ardhura rreth 3 – 4 miliardë lekë.
- Reduktimi i detyrimit të pagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për bizneset me xhiro 5-8 milionë lekë. Ky ndryshim parashikohet të sjellë një efekt në buxhetin e shtetit prej - 0.35 miliardë lekë.
- Zerimi i detyrimit të Tatimit mbi Fitimin për biznesin e madh me xhiro 8-14 milionë lekë. Ky ndryshim parashikohet të sjellë një efekt në buxhetin e shtetit prej -0.3 miliardë lekë.



Për më tepër situata e pandemisë ende nuk ka përfunduar dhe ne nuk e dimë se çfare do të na sjellë e ardhmja, ndaj realizimi i planit të të ardhurave për vitin 2021 duket tejet i vështirë dhe në rretana mosrealizimi, Qeveria do të duhet të rishikojë sërish buxhetin gjatë vitit, duke ulur shpenzimet dhe investimet, ose duke rritur edhe më tej nivelin e Borxhit Publik.




Fig.4. Të ardhurat për e parashikuara për vitin 2020 dhe 2021, Burimi MFE


Më poshtë paraqitet një tabelë përmbljedhëse e të gjithë të ardhurave që kontribuojnë në buxhet dhe niveli i kontributit të tyre, sipas FMN.

Lloji i taksave	Fakt 2019 (000)	I Pritshmi 2020 (000)	Projeksioni 2021 (000)	Rritja e pritshme per 2021 krahasuar me 2020
TVSH Neto TOTAL	132,412	128,101	143,500	12 %
Tatimi mbi fitimin	36,575	27,716	33,031	19.2%
Akciza	46,742	44,605	49000	9.9%
Tatimi mbi të ardhurat personale	46,124	36,305	41,000	12.9%
Taksat Nacionale Total	36,424	34,178	38,000	11.2%
Taksë doganore	6,482	6,216	6500	4.6%
TOTAL TATIME + DOGANA	304,759	277,121	311,031	12.2%
Kontributet e mbledhura	94,248	90,900	96,270	5.9%
TOTAL DPD + DPT (Kontributet)	399,007	368,021	407,301	10.6%

3.SHPENZIMET BUXHETORE

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2021 është planifikuar 587.6 miliardë lekë ose 34.9% e PBB, dukshëm më i lartë se sugjerimet e FMN në raportin e fundit.

Fig.1.5. Ecuria e Shpenzimeve të Buxhetit



Nga këto shpenzime, **shpenzimet e personelit** për vitin 2021, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, si dhe politikën e re të rritjes së pagave për dy sektorët prioritarë shëndetësi dhe arsim. Fondi vjetor për rritjen e pagave është planifikuar në shumën 8 miliardë lekë dhe parashikon rritjen e pagës për funksion me 40% për punonjësit shëndetësor, me një vlerë prej 4.5 miliardë lekë dhe rritjen e pagës për funksion me 15% për punonjësit mësimor me një vlerë prej 3.5 miliardë lekë. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike janë planifikuar në masën **91.87 miliardë lekë** ose **5.5% e PBB**.

Një tjetër zë shumë i rëndësishëm i shpenzimeve, janë **shpenzimet për interesa** parashikohen në nivelin **43.8 miliardë lekë** ose **2.6% të PBB**, shifër kjo që rritet vazhdimisht për shkak të rritjes së nivelit të borxhit. Për të bërë pak më të prekshëm koston e madhe të interesave në buxhet, po bëjmë një krahasim. Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit për interesa janë rreth 50 herë më të larta se shpenzimet për papunesinë dhe ndihmën ekonomike.



Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2021 (pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit), janë parashikuar në masën **45.89 miliardë lekë** ose rreth **2.7% e PBB-së**.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2021, janë parashikuar në masën **56.326 miliardë lekë**, me një rritje prej 5.3% më shumë se në vitin 2020.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej **193.97 miliardë lekë**. **Shpenzime të tjera sociale**, përfshin fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin **800 milionë lekë**.
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin **22.2 miliardë lekë** ose 1.3% e PBB.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej **1 miliard lekë** ose 0.1% e PBB.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej **2.2 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën **1.55 miliardë lekë** duke u rritur krahasuar me një vit më parë. Këto shpenzime shkojnë kryesisht për mbështetjen e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.

Niveli i Fondit Rezervë për vitin 2021, planifikohet në masën **4 miliardë lekë**, përkatësisht **2 miliardë lekë** Fond Rezervë i Këshillit të Ministrave, **1 miliardë lekë** fond kontigjence për mbështetjen e procesit zgjedhor dhe **1 miliardë lekë** fond rezervë për studime dhe projektme për projektet e investimeve publike strategjike që do të zhvillohet në vitin 2021.



4. Investimet Publike

Investimet Publike për vitin 2021 janë planifikuar në masën 7.2% e PBB, ose 120.6 miliardë lekë (duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 27 miliardë lekë). Në planifikimin e investimeve për vitin 2021 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu si dhe në vitin 2020, dhe në vitin 2021 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim.

Sipas Ministrië së Financave dhe ekonomisë në prioritetet e investimeve 2021-2023 do të jenë:

- Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Investimi në ujesjellësa, Reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar në masën 50% në vitin 2023;
- Në vitin 2023 synohet që të trajtohen rreth 50% të mbetjeve me landfill-e sipas standardeve, nga 30% që parashikohet në fund të vitit 2019;
- Për industrinë parashikohet zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për inspekimin dhe mbikqyrjen, sigurinë në punë për monitorimin e inspektimit dhe mbikqyrjes së sigurisë teknike të produkteve / pajisjeve / instalimeve në fushat e veprimtarisë së MIE;
- Për shëndetësinë parashikohet Mbulimi universal i popullsisë me shërbim shëndetësor duke parashikuar 6.4 milionë numër vizitash në periudhën 2021-2023, mbështetur në treguesit e sëmundshmërisë.



Megjithese ky duket të jëtë një vit i vështirë financiar, ku fokusi kryesor duhet të jëtë menaxhimi i krizes shëndetësore dhe procesi i rindërtimit, sërish buxhetit nuk i kanë shpëtuar as "shpenzimet e luksit" si për shembull një tjetër rikonstruksion i kryeministrisë më vlerë 200 milionë lekë.


\ 000 leke

Emërtimi i Projektit	Statusi projekti	Viti i Fillimit	Viti përfundimit	Vlera Totale e projektit	Financimi deri në 31.12.20	Buxheti 2020 - PLAN	Propozim MFE 2021
KRYEMINISTRIA				270,000	0	99,000	200,000
Planifikim, Menaxhim, Administrim				270,000	0	99,000	200,000
Rikonstruksion	vazhdim	2020	2023	230,000		59,000	200,000

Gjithashtu edhe aeroporti i Kukësit që prej vitesh është prezantuar me projekte 3D, i cili është planifikuar të ndërtohet me PPP do i kushtojë buxhetit të këtij viti 121 milionë lekë vetëm për shpenzime inxhinierike të pavarura për zbatimin e kontratës koncesionare.

\ 000 leke

Progrmi	Emërtimi i Projektit	Statusi projekti (vazhdim/ri)	Viti Fillimit	Viti përfundimit te financimit	Vlera Totale e projektit	Financimi deri në 31.12.2019	Buxheti 2020 - PLAN	Propozim MFE 2021
04560	TRANSPORTI AJROR				213,500	0	35,000	122,000
04560	Shërbimet inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit	vazhdim	2019	2023	210,000	0	34,500	121,000



5.KONCENSIONET

Për vitin 2021 pagesat vjetore neto që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare apo PPP, kapin vlerën rreth **14.46 miliardë leke**. Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, deri në vitin 202 janë 13 kontrata ekzistuese, të cilat marrin mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, edhe pse ka shumë kontrata të tjera pagesat e të cilave ende nuk kanë nisur.

Në krahasim me vitin 2020, kur shumë kontrata u ngrinë ose u reduktuan për shkak të situatës së vështirë të krijuar në buxhet nga Covid-19, (në total 7.9 miliardë lekë), pagesat për koncesionet do të rikthehen normalitetit në vitin 2021. Kjo shumë e parashikuar për pagesa koncesionesh në vitin 2021 është sa 16% e totalit të shpenzimeve kapitale të planifikuara.

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emertimi i Kontrates PPP	Viti i fillimit	Viti i perfundimit	Programi	Lloji i shpenzimit	në mijë Lekë					
							2018 Fakt	2019 Fakt	2020 I rishikuar	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	06220	Investime	601,429	631,317	242,770	49,124	0	0
	2	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2022	06220	Investime	752,771	752,770	190,000	752,770	752,770	0
	3	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	2015	2019	04320	Investime	1,355,108	1,505,822	0	0	0	0
	4	Ndërtimi dhe Operimi i Rruges së Arbrit	2018	2030	04520	Investime	0	3,910,860	1,662,000	4,105,100	3,055,000	2,844,000
	5	Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rruges Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investime	308,183	570,643	810,000	800,259	762,643	740,259
	6	Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Oriku - Dukat	2018	2030	04520	Investime	0	0	0	393,979	1,076,792	1,039,400
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Ndërtimi dhe Operimi i Rruges Milot - Baldren	2018	2032	04520	Investime	0	0	0	65,000	312,000	987,945
	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	01150	Korrente	1,525,579	1,509,659	1,140,896	1,580,698	1,628,118	1,676,962
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Konçesioni/PPP Kontrolli baze i popullsisë 35-70 vjeç (check up)	2015	2024	07220	Korrente	876,083	876,083	426,083	876,090	876,090	876,090
	2	Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2015	2024	07330	Korrente	1,625,581	2,163,282	1,310,000	1,704,982	1,750,000	1,750,000
	3	Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës në 5 spitale rajonale)	2016	2025	07330	Korrente	738,911	804,388	733,000	779,000	827,000	879,000
	4	Ofrimi i Shërbimeve laboratorike spitalore	2019	2028	07330	Korrente	0	0	400,000	1,280,444	1,290,241	1,300,136
Bashkia Tirane / Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	1	Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranë	2017	2024	09120	Investime	0	0	0	685,325	1,515,507	1,457,308
Ministria e Infrastruktues dhe Energjise / Bashkia Tiranë	1	Per ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e vendeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike	2017	2046	06220	Korrente	977,000	977,125	980,000	1,386,921	1,553,351	1,739,753
	13	TOTALI					8,760,645	13,701,949	7,894,749	14,459,692	15,399,512	15,290,853
Totali i te Ardhurave Tatimore per periudhen 2018-2023							419,333,310	426,270,680	394,191,000	437,011,847	480,721,955	519,018,587
Respektimi i Rregullit Fiskal (perpjese e pagesave te PPP ndaj totalit te te ardhurave tatimore te vitit paraardhes buxhetor me pak se 5%)							2.2%	3.3%	1.9%	3.7%	3.5%	3.2%

Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit deri ne vitin 2020, Burimi MFE

Koncesionet e reja të parashikuara për vitin 2021.

Në planin e investimeve të vitit 2021 parashikohen një sërë koncesionesh të reja që të fillojnë këtë vit të vjëlën para publike, të cilat janë kryesisht në ndërtim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës rugore.

\000 leke

Progrmi	Emërtimi i Projektit	Statusi projekti	Viti	Viti	Vlera Totale projektit	Financimi d në 31.12.2019	Buxheti 2020 - PLAN	Propozim M€ 2021
		(vazhdim/I ri)	Fillimit	përfundit te financimit				
04520	TOTAL BUXHETI I KONTRATAVE KONCESIONARE				90,876,622	4,291,866	2,513,869	5,364,338
04520	Kontrata e Koncesionit /PPP per permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e rruges se Arbrit	vazhdim	2018	2031	40,320,000	3,780,000	1,520,000	3,910,000
04520	Supervizioni i kontrates koncesionare per ndertimin, operimin, mirembajtjen e rruges se Arbrit	vazhdim	2018	2022	535,153	130,860	135,110	170,000
04520	Oponence Teknike per kontraten e koncesionit per permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e rruges se Arbrit	vazhdim	2020	2020	27,100	0	2,000	25,100
04520	Subvencioni I kontrates koncesionare per ndertimin, permiresimin, shfrytetezimin, mirembajtjen dhe rehabilitimin e autostrades Milot - Morine	vazhdim	2019	2032	7,564,375	242,977	740,259	740,259
04520	Supervizioni I kontrates koncesionare per ndertimin, operimin, mirembajtjen e rruges Milot - Morine	vazhdim	2017	2022	290,412	138,029	70,000	60,000
04520	Ndertimi i dhe operimi I rruges Milot - Balldre	I ri	2022	2033	31,665,160	0	0	0
04520	Supervizioni I punimeve per ndertimin dhe operimi I rruges Milot - Balldre	I ri	2021	2023	241,580	0	0	50,000

Progrmi	Emërtimi i Projektit	Statusi projekti	Viti	Viti	Vlera Totale projektit	Financimi d në 31.12.2019	Buxheti 2020 - PLAN	Propozim M€ 2021	
		(vazhdim/I ri)	Fillimit	përfundit te financimit					
1	04520	Kontrata e Koncesionit /PPP per projektimin, ndertimin dhe mirembajtjen e rruges Porti I Jahteve - By Pass Orikum -Dukat (Ura e Shen Elizes)	I ri	2021	2033	9,982,742	0	0	311,879
2	04520	Sherbime konsulence te pavarura per zbatimin e kontrates koncesionare/PPP, per projektimin, ndertimin dhe mirembajtjen e rruges Porti I Jahteve - By Pass Orikum - Dukat (Ura e Shen Elizes)	I ri	2020	2023	233,000	0	46,500	80,000
3	04520	Oponence Teknike per kontraten e koncesionit per permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e rruges Porti I Jahteve -By Pass orikum - Dukat (Ura e Shen Elizes)	I ri	2021	2021	2,100	0	0	2,100

6. Deficiti Buxhetor

Si në vitin 2020, parashikohet të ketë një diferencë të lartë mes shpenzimeve dhe të ardhurave, cka do të detyrojë qeverinë të marrë borxh për të realizuar projektet e saj të investimeve, në një vit elektoral. Deficiti buxhetor për vitin 2021 planifikohet të jëtë në nivelin 6.5% të PBB nga rreth 6.8 i pritsëm në vitin 2020. Në vlerë absolute, deficit buxhetor është parashikuar në 108 miliardë lekë ose 880 milionë eur, nga gati 1 miliardë euro që është i pritsmi këtë vit.

7. Sugjerimet dhe ndryshimet e propozuara nga e Komisionit Pralamentar të në Projektbuxhet

Komisioni sugjeron që në projektbuxhetin e vitit 2021, të shtohen shpenzimet me 1.2 miliardë lekë, për të përfshirë paketën e rimbursimit të ilaçeve për kurimin nga pandemia Covid-19, në listën e ilaçeve të rimbursueshme. Rimbursimi i çmimit të ilaçeve nga buxheti i shtetit do të bëhet për të gjithë qytetarët dhe në të gjithë vendin. Për këtë qëllim, Komisioni propozon që në projektbuxhetin e vitit 2021 të shtohen shpenzimet për këtë kategori sociale me 2.5 miliardë lekë.

Gjithashtu, Komisioni propozon rritjen e mbështetjes buxhetore për Agjencinë e Efiçencës së Energjisë dhe për investimet e huaja, si dhe zgjidhjen e disa problematikave në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhënia e shpërblimit për naftëtarët dhe mbështetja për disa ndërmarrje që janë në konservim, për të mos krijuar problematika në drejtim të pagesës së detyrimeve të tyre.

Rritja e totalit të shpenzimeve të buxhetit me 5 282 milionë lekë, sipas Komisionit Parlamentar të Ekonomisë duhet të mbulohet nga: **Rritja e të ardhurave tatimore nga TVSH me 4 641 milionë lekë dhe pjesa tjetër nga zvogëlimi i shpenzimeve operative.**

8. Rindertimi i Teatrit të ri Kombëtar me paratë ë buxhetit të shtetit

"Teatri nuk do ndërtohet me para nga buxheti i shtetit, nuk do të hidhet asnjë qindarkë nga fondet e tërmetit apo të Covid-it. Do të ndërtohet me financimin e Bashkisë së Tiranës 100% dhe me garanci të qeverisë, do të merret si kredi. Një kredi që s'ta jep kush për këto të tjerat", tha Rama.

Por pas dështimit të Bashkisë së Tiranës për të siguruar financim, edhe kjo kosto iu shtua buxhetit të shtetit, për më tepër në një vit kritik si 2021. Pas kërkesës së Bashkisë së Tiranës, Komisioni Parlamentar i Ekonomisë propozoi frijjen e buxhetit të Ministrisë të Kulturës 4.4 miliardë lekë. Jo vetëm kaq, por duket se kosto e ndërtimit të Teatrit të ri kombëtar është rritur, sepse projekti fillestar ka qënë 30 milionë euro, mderkohë nga buxheti i shtetit tani po kërkohen 36 milionë euro për rindertimin.



Përfundime dhe rekomandime

Në kushtet kur rindërtimet e tërmetit kërkojnë deri në 60 miliardë lekë sipas MFE, e shumë angazhime financiare janë ndërmarrë përtej kapaciteteve të financave publike gjatë këtyre viteve, situata paraqitet shumë e zyrtë. Gjatë këtyre viteve, Qeveria nuk arriti të ulte borxhin publik, nën-perfomoi në rritjen ekonomike të vendit, nuk zgjeroi të ardhurat nga tatimet, krijoi sërish detyrime të prapambetura, zgjeroi faturën e vendimeve gjyqësore dhe arbitrazhit, nuk realizoi mirë-administrim të sektorit të energjisë, shpenzoi në mënyrë ineficente, dhe ndërkohë ndërmori angazhime shumëvjeçarë në forma të PPP-ve.

Si rrjedhojë, goditja e dyfishtë nga tërmeti dhe pandemia i gjeti financat publike në veshitësi dhe pa kapacitete. Nëse borxhi publik do të ishte në nivelet e 70-73% të PBB-së si pasojë e zbatimit të reformave deri në vitin 2019, e jo 83% sa është sot, do të kishim më shumë hapësira fiskale dhe do të mund t'i lejonim vendit frymëmarrje nëpërmjet borxhit publik. Fatkeqësisht kjo nuk ndodhi por duhet të shërbejë si mësim për në vijim.

Të ardhurat duhet të parashikohen me realizëm, pritshmëritë më të larta se realiteti nuk sjellin gjë tjetër përveç se rritje të mëtejshme të borxhit publik. Po ashtu shpenzimet duhen prioritizuar, dhë të përqipemi të fokusuar më shumë në investime që lidhen drejtpërdrejt me mirëqëniën e njerëzve, në shëndetësi e në arsim. Nuk e kemi luksin për rikonstrukcione apo lysterje të fasadave, në këtë vit krize të madhe shëndetësore dhe financiare.

Për këtë kërkohet një diskutim real, transparent dhe urgjent. Jemi në kohë fushate elektorale dhe risku është vërtet i madh. Duhet lënë mënjanë populizmat e kësaj periudhe, dhe duhet treguar përgjegjshmëri maksimale.



#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE